




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo  
Finansija, Rada i Transfera –  
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës si dhe në bazë të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

## V E N D I M

### **PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE QË OFROJNË TRAJNIME PËR AFTËSI TË BUTA PËR DERI 300 PUNËKËRKUES (MOSHA 18 – 24 VJEÇ) NË 7 QENDRAT KRYESORE TË KOSOVËS**

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, respektivisht në formë indirekte nga mbështetja e Qeverisë Gjermane përmes projektit të GIZ Kosova “Fit for Jobs”, kodi buxhetor 43100/0412 tek Kategoria Subvencione dhe Transfere. Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare do të jetë EUR 5,600.00.
3. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-së, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
  1. Tekstin e thirrjes publike
  2. Udhëzimet për aplikantët
  3. Formularët e aplikimit

5. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare, respektivisht APRK –së (*ëeb faqe*).
6. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
7. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit.
8. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.
9. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesin/t e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr Vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
10. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
11. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti i Tregut të Punës në kuadër të APRK.
12. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

  
Jehona Rexha  
Zv.Drejtoreshë e Agjencisë së  
Punësimit të Republikës së Kosovës

Vendimi iu dërgohet:

- Departamentit të Tregut të Punës
- Arkivës së APRK